



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 23.04.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23.04.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "GASHI ING " SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës pjesa –I-rë", me Nr. të Prok: 632-21-574-5-1-1, nxjerr:

V E N D I M

- I. **Aprovohet** si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim Operatori Ekonomik "GASHI ING " SH.P.K e dt.23.04.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës pjesa –I-rë", me Nr. të Prok: 632-21-574-5-1-1, Nr. Brendshëm 632-21-003-511, kundër Dosjes së tenderit, te AK –së, të datës 06.04.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
2. Përmirësohet DOSJA E TENDERIT E AUTORITETIT KONTRAKTUES e publikuar me datë: 06.04.2021;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëj përmisimin e Dosjes tenderit-specifikimit teknik.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Meqë Operatori Ekonomik "GASHI ING " SH.P.K, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës pjesa –I-rë", me Nr. të Prok: 632-21-574-5-1-1, Nr. Brendshëm 632-21-003-511,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 21.04.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

1.Për pretendimin tuaj se:

Më 21.04.2021 keni njoftuar se kriteret e dosjes së tenderit do të ndryshojnë, por ju e keni ngarkur të njejtën pa ndryshime. Kriteret e nenit 9.1 & 9.2 të FDT (dosjes së Tenderit) Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses referenca të cilat dëshmojnë se ka kryer shërbime në projektim të ndërtimit të lartë në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. Në një vlerë prej jo më pak se 430.000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjajshme.

Pas rishikimit të dosjes tenderit Autoriteti kontraktues sqaron se: Gjatë përpilimit të dosjes së tenderit ka rrjedhur ky gabim teknik prandaj pretendimi juaj është i bazuar dhe Autoriteti kontraktues do të bëjë përmirësimin e Dosjes tenderit-specifikimit teknik;

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur që të bëjë përmirësimin e Dosjes tenderit-specifikimit teknik.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara
Arkivit të Komunës

z.Faton Gutaj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

